

PETRAQ PEPO

MBI NJË KRONIKË NË VARGJE TË VITIT 1740 TË MIHAL GORËS

Mihal Gora¹ lindi në qytetin Shipskë² të Shqipërisë aty nga viti 1700, ku edhe mori mësimet e para, të cilat pastaj i vazhdoi në shkollën e Voskopojës. Pothuajse gjatë gjithë jetës punoi në këtë qytet të Shqipërisë së Jugut, i cili në shek. XVIII ishte mjaft i zhvilluar nga ana ekonomike e kulturele. Mihal Gora, i njohur edhe me emrin Mihal Shipskioti ose Shipskalliu, u largua për pak kohë nga Voskopoja (në kohën e turbullirave të mëdha të v. 1769³, që u shkaktuan nga anarkia feudale), por u kthye përsëri, ku me ndonjë ndërprerje, vazhdoi veprimtarinë e tij gjersa vdiq. Lidhur me datën e vdekjes, në një kodik të Voskopojës gjendet edhe ky shënim kronikal: «Ditë e mërkurë, 2 tetor 1790, pushoi i ndjeri qir Mihal i Gorës — i përjetshëm kujtimi i tij». Ndonjë autor, si episkopi i Sardës, Gjermanoi, Mihalini e Gorës e ve në radhën e episkopëve të diocezes së Gorë-Mokrës⁴, kurse ai asnjëherë nuk ka qenë klerik. Autori në fjalë ngatrron Mihalini me të jatin, i cili në historinë kishtare të patriarkisë së Ohrit, është i njohur me emrin Theodhor i Gorës. Ky klerik, kur shërbente si prift, ka qenë i martuar, bile ka patur dhe fëmijë; por kur i vdiq e shoqja, patriarkia e Ohrit e dorëzoi arkierë të episkopatës së Gorë-Mokrës⁵. Kjo episkopatë, pas shkrirjes së patriarkisë së lartpërmendur, bashkë me Shipskën, u përfshi në administratën e Mitropolisë së Durrësit, juridiksioni fetar i së cilës zgjatej gjer te ura e Maliqit, atje ku fillon fusha e Korçës.

1) Bibliographie hellénique, on description raisonnée des ouvrages publiés par les grecs au dix-huitième siècle par Em. Legrand O.P. complétée et publiée par M. L. Petit et H. Pernot Tom. I. Paris 1918 p. 263; Evlogji Kurila: Γρηγόριο ὁ Ἀργυροκαστρίτης. Ἐν Ἀθῆναις, 1935 σ. 81, 82, 87, 131-133. Joaqim Martiniani: Συμβολαί εἰς τὴν ἱστορίαν τῆς Μοσχολόλεως. Ἀθῆναι, 1939 σ. 19, shënim 2 ff. 28-30. Konst. Skënderi: Ἱστορία τῆς ἀρχαίας καὶ συγχρόνου Μοσχολόλεως. Ἐν Ἀθῆναις 1928, σ. 31; J. Martiniani: Ἡ Μοσχόπολις 1330-1930, 1957 σ. 65, 66, 80, 179, 184, 212, 258. I.M. Qafëzezi: Protopapë Theodhor Kavalioti, monografi e pabotuar f. 302

2) Shipska, që shtrihet në pellgun e Voskopojës, në shek. XVIII ka qenë qytet, ku ka lulëzuar kryesisht ekonomia zejtaro-tregtare dhe gjatë ekzistencës së patriarkisë së Ohrit gjer në kohën kur u shkri kjo patriarki, përfshihej në episkopatën e Gorë-Mokrës (N.A. Hacı: Aromâni Comert, industrie, artes, expansione, civilizacie. Foscani, 1936 f. 152; K. Skënderi op. c. f. 89)

3) Edhe Shipska u shkatrrua nga anarkia feudale, siç u shkatrruan edhe qendra të tjera ekonomike: Vithkuqi, Nikolica, Niça, Llënga e Grabova (Gustav Weigand: «Die Aromunen», Leipzig, I, 1895, ff. 100, 197; J. Martiniani op. c. f. 83. Pas këtij shkatrrimi Shipska mbeti dhe vazhdon të jetë një fshat i vogël.

4. Μητροπολύτου Σάρδεων, Γερμανού: Ἐπαρχίαν Ἡπειροῦ καὶ Ἀλβανίας, πῆ Ἡπειρωτικά χρονικά 1937 σ. 55

5) J. Martiniani op. c. f. 33

Mihal Gora ka qëndruar afër, bile edhe ka marrë pjesë aktive në ngjarjet e rëndësishme të qytetit të Voskopojës. Në kohën e tij, d.m.th. në shek. XVIII, Voskopoja, Korça, Vithkuqi u bënë qendra ekonomike me rëndësi për të gjithë trevën. Këto qendra, krahas marrëdhënieve tregëtare lidhen marrëdhënie edhe me institucionet kulturele të Europës perendimore; prandaj edhe në shkollat e Voskopojës, ku ka shumë mundësi të ketë dhënë mësim Mihal Gora, kishte ndikuar fryma e doktrinave filozofike përparimtare, të cilat ishin përhapur edhe në qendra të tjera ekonomike e kulturele të Gadishullit Ballkanik. Në tipografinë e Voskopojës⁶ botoheshin vepra të ndryshme, ndër të cilat edhe akulluthitë e shejtëve të shquar ballkanikë⁷. Mihal Gora mori pjesë në botimin e tyre.

Veprimtaria e tij është e gjerë, por deri sot janë zbuluar vetëm disa shkrime, midis të cilëve permendim:

1. Dy letra dërguar arkiepiskopit të Ohrit.
2. Një kronikë në vargje e vitit 1740.
3. Kodiku i manastirit të Shën Prodhromit të Voskopojës⁸.
4. Kanonizma e bakajve të rufetit të Voskopojës⁹.

Këto shkrime, të hartuara në gjuhën greke, japin materiale me rëndësi për jetën e brendëshme ekonomike, shoqërore dhe kulturele të vendit tonë në shek. XVIII. Ato përshkohen nga fryma e patriarkisë së Ohrit, e cila, duke qenë e udhëhequr nga idetë e lirisë dhe të bashkëpunimit luftarak të popujve të Gadishullit Ballkanik, u bë për këta popuj vëllezër, pra edhe për popullin shqiptar, një vatër me rëndësi bashkëpunimi, për të përmbysur sundimin e rëndë feudal ushtarak turk.

Kronikën në vargje të vitit 1740 Mihal Gora e shkroi me rastin e një zie që u përhap në Shqipërinë e Jugut, në trevën e Maqedonisë dhe në vise të tjera të Rumelisë. Në një shënim kronikal shkruar në manastirin e Shën Prodhromit thuhet: «1740. Ndodhi uri e madhe dhe shtrejtësi, killa e grurit [vajti] 3000 aspra dhe [zia mbajti] nga shkurti gjer në qershor»¹⁰. Këtë uri dhe të ftohtin e madh të muajve të dimrit Mihal Gora e përshkruan me dhemshuri të madhe dhe e harton në vjershë, të cilën ia dedikon patrikut të Ohrit, Joasaf.

Në vitin 1779 ai filloi të shkruajë kodikun e manastirit të Shën Prodhromit të Voskopojës. Për të hartuar këtë vepër me vlerë të madhe për jetën e brendëshme të qytetit në fjalë, me durim të madh, kërkoi dhe mblodhi: tradita popullore, kujtime nga pleqtë, shkresa të shkruara më parë e me zotësi, i lidhi, i redaktoi dhe më në fund i plotësoi me ngjarje të ndryshme të kohës së tij. Po këtë vit, në Voskopojë u zhvillua një konferencë ku merrnin pjesë protopapë Theo-

6) E. Kurila op. c. f. 85, 132.

7) E. Kurila op. c. f. 84-86.

8) Këtë kodik, ku janë bërë dhe shtesa pas vdekjes së Mihal Gorës, e ka botuar J. Martiniani me këtë titull: *Συμβολαί εις τήν ιστορίαν της Μοσχολέως Α'* "Η ιερά μονή του τιμίου Προδρομου κατά τον έν αύτη κώδικα (1630-1875 . . .) 'Αθήναι, 1939.

9) Kjo kanonizëm është shkruar në kodikun e kishës së Shën Harallambit të Voskopojës.

10) J. Martiniani: *Συμβολαί* . . . f. 56

dhor Kavalioti, Kostë Berati, Dhaskal Thodhri, saqelar Dhanili etj., për të zgjidhur një mosmarrëveshje midis arkiereut të Durrësit dhe atij të Beratit për kufitë e diocezave të tyre. Thuhet se Mihal i Gorës u takua me miqtë që kishin ardhur nga Elbasani e nga Berati.

Mihal Gora ka shkruar në gjuhën greke, e cila përdorej nga pjesa më e madhe e popujve ortodoksë të Gadishullit të Ballkanit si gjuhë kulturele dhe kishtarë¹¹. Ka mundësi që edhe Mihal Gora të ketë përdorur për nevoja didaskalike gjuhën shqipe, duke e shkruar me shkronja greke, ashtu siç kanë bërë edhe bashkëkohësit e tij protopapë Theodhor Kavalioti, Dhaskal Dhanili, Dhaskal Thodhri, Kostë Berati¹², më vonë Kostë Cepi etj. Koha dhe kërkimet e reja do të sqarojnë edhe më mirë veprimtarinë e gjatë arësimore-kulturele të Mihal Gorës nga Shpaska e Shqipërisë.

* * *

Kronikën në vargje të vitit 1740 të shkruar nga Mihal Gora, e kemi nxjerrë nga kodiku i manastirit të Shën Prodhromit të Voskopojës, i cili, siç e pamë më lart, është botuar nga arkireu J. Martiniani¹³ në Athinë më 1939. Kronika në fjalë, që gjendet në shënimin 2 të këtij kodiku, në faqet 58-61, e gjykuar nga pikëpamja artistike, ka të meta e dobësi si nga ana gramatikore ashtu edhe nga ajo e vjershërimit, pasi autori në këto vargje nuk ka respektuar as rregullat më elementare të metrikës.

Dihet se Mihal Gora ka qenë një njohës i mirë i gjuhës greke, gjë që duket edhe nga disa shkrime të tija, si p.sh. nga dy letra që i ka dërguar arkiepiskopit të Ohrit, njëra e botuar në akollutinë e Shën Naumit dhe tjera në atë të Shën Klementit; por kronikën e vitit 1740, që po botojmë më poshtë, Mihal, duke dashur ta përhapë sa më shumë, e ka shkruar në vargje, duke u përpjekur të përdorë një gjuhë greke të thjeshtë e popullore, në mënyrë që kronika në fjalë të kuptohej edhe nga ata që kishin bërë pak shkollë¹⁴.

Petraq Pepo

11) Shih dhe «**Historia e letërsisë shqipe**», vëll. I-rë. Tiranë, 1959 f. 243, 305.

12) **Po aty**, f. 306-314.

13) Joaqim Martiniani, i cili ka lindur në Voskopojë më 1875 nga prindë oparakë, ka shërbyer si episkop edhe në Shqipëri si p.sh. në Berat; ay vdiq më 1956, si mitropolit i qytetit të Ksanthit.

14) Për rëndësinë edhe në pikëpamje gjuhësore të kësaj kronike në vargje, shih studimin e prof. N. Politi, në **Δελτίον ἔθνολογικῆς Ἐταιρίας**, Α σ. 256—269.

Fort i lumturi atë,¹⁵ mos të duket e pa vënd
 nëse goja jonë, fjalë të hidhur ka për të thënë,
 se ndonëse në të hartuarit e fjalës është shumë e vogël
 por rrethana e kohës u bë tepër shkatrrimtare

•

prandaj qëllimi ynë nuk është që të tregojë të gjitha,
 por sa që të lerë në kujtimin e brezave të ardhshëm,

•

gjithë sa shkaktuan uria dhe shtrenjtësia
 me tregim shumë të shkurtë, siç është e vërteta

•

jo me oratorira dhe me fjalë zbukuruese
 që i bëjnë tregimet të errët dhe të pa qartë.

•

Por me shprehje të thjeshtë dhe me gjuhën që flitet,
 që ta kuptojë gjithkush dhe që të mbahet mënd përgjithmonë.

•

Prandaj me shumë të lutura po të kërkoj lejen
 dhe kështu po filloj tregimin e urisë.

•

Filloj pra dhe tregoj më parë çfaqjen e një shenje
 që u duk kudo, në të katër anët e dheut,

•

sepse më njëmijëeshtatëqintetridhjeteshtatë
 të këqija ishin paralajmërimet për gjithë sa ngjanë.

•

Sepse më pesë të muajt dhjetor,
 në mbrëmje duke u gdhirë Shën Kolli

15) Këtu bëhet fjalë për Joasafin, të cilit Mihal Gora i kushton këtë kronikë me vargje.

Joasafi lindi më 1660 në Voskopojë dhe vdiq në Ohri më 1745. Që në moshë të re hyri në shërbim të kishës dhe kaloi gradualisht në shkallët: dhjak, prift, episkop i Prespës më 1706 gjer më 1709, mitropolit i Korçës më 1709 gjer më 1719 dhe patrik i Ohrit prej vitit 1719 gjer më 1745. Në kohën e patrikut Joasaf, në trevën Ohri-Korçë-Voskopojë e Vithkuq, u ngritën një radhë institucione arësimore, u ndërtuan kisha me vlerë të madhe artistike përsa i përket arkitekturës e gravurës në dru. (Shih dhe Heinrich Gelzer: «Der Patriarchat von Achrida», Leipzig, 1902 në faqe të ndryshme).

•
 një komet fort i madh, me pamje të zjarrtë, u duk
 nga ana e veriut paralajmërues i madh të këqijash,

•
 sa që këtë e panë Lindja dhe Perëndimi,
 dhe i paratregoi botës shtypjet dhe shqetësimet

•
 por le pa treguar, trazirat e mbretërive¹⁶,
 pajtimet¹⁷ e Turkut, të Qezarit¹⁸ e të Moskovit¹⁹.

•
 Është trajtesë e mjaftueshme për historitreguesit
 dhe përshkruaj shkurt vetëm dëshpërimin e të uriturve,

•
 se më njëmijëeshtatëqintedyzet
 medet! Rumelinë²⁰ e plakosnë të gjitha të këqiat.

•
 Kur mbreti sulltan Mahmudi²¹ mbretëronte
 rrezikohej të humbiste Maqedonia nga uria.

•
 Dimër shumë i keq dhe i ftohtë në kulm,
 kurse le [pa përshkruar P.P.] kohën e gjatë, të tokës pa bar

•
 sepse gjer në ditën e Shën Gjergjit²²,
 që është më njëzetetë të muajt prill

•
 kurkush nuk pa me sy gjelbërim,
 që të gëzojë të paktën bukurinë e tokës.

16) Politika europiane në gjysmën e parë të shek. XVIII ka qenë shumë e acaruar.

17) Më 1739 me traktatin e Belgradit, Turqia në një anë, Austria dhe Rusia në anën tjetër, që ndodheshin në luftë midis tyre, hynë në marrëveshje dhe lidhën paqe.

18) Këtu bëhet fjalë për Karlin e VI, i cili si shef i monarkisë austriake (1711-1740) mbante dhe titullin Qezar dmth. Perandor, pasi qysh prej vitit 1438, princët elektorë të Perandorisë së shenjtë gjermanike dmth. të Gjermanisë, mbanin kurorën perandorake të familjes së Habsburgëve.

19) Moskov — në kohën e sundimit turk i thonin Rusisë.

20) Rumeli — pjesa europiane e Perandorisë turke.

21) Këtu bëhet fjalë për Mahmudin e I-rë, i cili ka qenë sulltan i turqve në vitet 1730-1754.

22) Kremtja fetare e Shën Gjergjit nuk bie gjithnjë më 23 prill, ajo lëviz sipas lëvizjes së Pashkëve të mëdha.

*

Kisha psalte, sot bie erë pranverë
kurse moti filloi me shumë të ftohtë të hedhë dëborë.

*

Por o e keqe, më e keqe nga gjithë të këqiat!
dhe ç'dëshpërim plakosi, të varfër e të gjithshkëlqyeshëm

*

se në Rumeli ra një uri shumë e madhe
dhe në çdo lloj një shtrenjtësi shkatrrimtare.

*

Që nga muaji shkurt e gjer dhe në atë të qershorit,
oka e bereqetit ishte me njëzeteshtatë aspra²³
kështu që dhe një zotëri i math dëbonte atë që kishte shërbëtor.

*

Shumë bluanin levezhga drurësh, përzjerë me thjerza
dhe i hanin të gatuar që të mos pësonin vdekje të hidhur.

*

Përzjenin një okë miell elbi
me dy okë baltë të bardhë, me zemër të dërmuar.

*

Dhe duke gatuar kështu, o ç'fatkeqësi!
e duke e përtypur e hanin me shumë neveri

*

Bërsitë e rrushve i nxirnin prej plehu
dhe duke i bluar të thata, i hanin me miell.

*

Me të shumtëve i u ndryshua pamja e fytyrës²⁴,
gjë që, kurrë se mban mënd ndonjë prej njerëzve,

*

aq sa duke ecur, nuk arrinin në vendin ku donin,
por duke u penguar binin pa ndjenja, keqas.

*

Rroba dhe ç'kishin i dorëzonin për asgjë
dhe dëshpërimin e urisë, e zbutnin me pa burrëri

23) Aspër — një farë monedhë e vjetër turke, e argjendë, quhet dhe akçe. Në shek. XVI dhe të XVII, tri aspra kanë qenë baras me një para.

24) Tiparet e fytyrës së shumë njerëzve, nga të pangrënët u dobësuan dhe morën formë të shëmtuar.

*
Për këtë shkak, shumë të varfër prishnë shtëpitë e tyre,
dhe pa ndonjë çmim shitën tërë lëndën.

*
Fëmijët e tyre, prindët i shitën për të holla
pa kursyer shpirtrat e fëmijëve të tyre,

*
për të marë tri killë ²⁵ grurë,
medet! bëheshin vrasës të fëmijëve të tyre,

*
duke i dorëzuar në duar të botës,
e duke i bërë robër e të huaj për të mirat qiellore

*
dhe të mos kishin arritur me kohë Lindja dhe Perëndimi
me galera nga deti, për të shpërndarë bereqet,

*
rrezikoi të humbte gjithë njerëzit e saj
e mjera Maqedoni dhe të nginjëj skëterra.

*
Dhe ç'them vetëm mbi tregimin e urisë
nuk përshkruaj fatkeqësitë e tjera njerzore,

*
sepse nuk erdhi mjerimi vetëm nga uria,
por dhe shtrenjtësi për çdo send për një kohë të gjatë,

*
se oka e elbit si edhe e tërshërës [kostonte P.P.]
aq sa që s'mand mënd njeri që kurse ka lindur djelli.

*
Qetë, dhentë dhe gomarët ngordhën
kurse kuajtë, u shkatrruan pa masë.

*
Mishrat [ishin P.P.] të ligëta dhe shumë të shtrenjta,
dhe nuk mjaftonte kjo, por dhe shumë të rralla,

25) Killa, në kohën e sundimit turk, ka qenë një masë kapaciteti dhe peshi-
mi për drithrat. Një killë grurë në shek. XVIII ka qenë baras me 50 okë.

*
 për njëzet aspra oka e mishit të kaut,
 që asnjë dhëmbi s'ia linte rrënjën të fortë²⁶.

*
 I ligët ishte dhe mishi i deshve,
 dhe çmimi i një oke ishte dy dhjetshe²⁷ e gjysmë.

*
 për tetëmbëdhjetë aspra, ishte dhe oka e perimeve
 që me të vërtetë më dridhet shpirti ta them.

*
 Dhe oka e kripës ishte dymbëdhjetë aspra,
 ndëshko, o Zot, shitësit me dënim të rëndë!

*
 Vera vajti tetë dhe nëntë aspra,
 dhe gruaja e varfër s'merte tamam një okë.

*
 se përzenin verën me ujë,
 dhe atë që e pinte, e frynte si lëkurë dhie.

*
 Dhe vaji u bë pesëdhjetë aspra
 si dhe gjalpi për tetëdhjetë aspra.

*
 Ay që do të jepte tetë dhe dhjetë para²⁸
 kështu ulli dhe djathë mund të blinte.

*
 Barra me dru ishte për gjashtëdhjetë aspra
 dhe vështirë të peshonte pesëdhjetë okë²⁹.

*
 Ndruhem, me të vërtetë të them edhe këtë
 që çdo vezë u bë një aspër e gjysmë.

*
 Sa për pemët u bë mungesë e madhe
 se asnjëri s'i shikonte, të thotë, të paktën, me shëndet.

26) Mishi prej bagëtish të mplakura edhe kur zjehej ishte i fortë.

27) Dhjetshi — monedhë e vjetër turke, e cila ka qenë baras me 10 para.

28) Para — monedhë e vjetër turke, 1/40 e groshit.

29) Okë — masë peshe katërqind derhemsh baras me 1 kilogram e 408 gram.
 Në kohën e Turqisë oka nuk ka qenë e barabartë në të gjitha krahinat e Shqipërisë, kështu në Korçë ka qenë 400 derhem, në Kavajë 450, në Berat 500.

*

Këto shkaktoj anomalia e kohës
por të gjitha u bënë me pëlqimin e Zotit,

*

sepse e teproi mëkata e njerëzve
dhe në të gjithë u rrënjos shpirtkeqësia

*

Por bëju i mëshirshëm o mbret Isu Krisht
Krijues dhe mbrojtës i të dukurave dhe të padukurave

*

dhe ajo që ndodhi në kohët tona
të mos ngjasë kurrë tjetër herë, për hir të mëshirës s'Ate,

*

por atje mund të tepronte mëkata jonë e keqe
le të jetë më i shumtë hiri yt i shenjtë

Shërbëtor i bindur,
Mihal i së Gorës.

